



## Aplikim për vizë punësimi në sektorin e kujdesit infermieror në Gjermani

*(Ndhmës infermier, Infermierë si edhe personel përkujdesjeje për moshat e treta si edhe për ata që janë në proces njohjeje)*

Ju lutemi lexojeni me kujdes këtë fletë informacioni dhe formularin e aplikimit dhe përmbajuni kërkesave të përshkruara aty.

Formular të plotësuar pjesërisht ose dokumentacione të paplota mund të çojnë në kthim të aplikimit. Një regjistrim i ri për takim ka kohë të gjatë pritje.

Gjatë procesit të aplikimit të vizës ambasada duhet të përfshijë në vendimmarrje edhe autoritetet përkatëse në Gjermani. Procesi si rregull zgjat 2-4 jave, në raste qëndrimesh të mëparshme në Republikën Federale zgjat edhe me shume. Ju lutemi të keni mirësinë që pyetje rreth gjendjes aktuale të aplikimit, nuk mund tu përgjigjemi brenda 5 javëve të para, duke filluar nga momenti i aplikimit.

### Për aplikim ju nevojiten dokumentat e mëposhtëm ashtu si janë përshkruar

1.	<b>Formular aplikimi për vizë kombëtare</b>	Në gjermanisht ose anglisht, <b>2 copë</b> të plotësuar tërësisht dhe me shkrim të lexueshëm, të nënshkruar nga aplikuesi.
2.	<b>Tarifa</b>	Tarifat dhe detyrimet duhet të <b>paguhen kesh në monedhën shqiptare LEK</b> . Tarifa është 75 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit.
3.	<b>Fotografi</b>	<b>3 fotografi identike biometrike</b> , jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhesia 45 X 35 milimeter Ju lutemi të ngjisni dy fotografi në formularët e aplikimit dhe fotografinë e tretë sillini shtesë me vete.

### Për secilën kategori kërkohen dokumentat e mëposhtme shtese

si

### Ndhmës infermier

Dokumentat e mëposhtëm duhet të dorëzohen në momentin e aplikimit në original edhe dy kopje

4.	<b>Kontratë pune ORIGINALE ose Oferte për vend pune</b>	Te nënshkruara nga punëdhënësi dhe punëmarrësi duke u përcaktuar profesioni <b>Ndhmes infermier</b> , <b>Paga bruto</b> , <b>orët e punës/ javë</b> dhe <b>fillimi</b> më i afërt i punësimit të planifikuar.
5.	<b>Njohuri të gjuhës gjermane</b>	<b>Niveli A 2</b> i Kuadrit të Përbashkët Evropian për Referencat e Gjuhëve (KPERGJ).

OSE

<b>Infermier ose personel përkujdesjeje për moshat e treta</b>		
<b>Dokumentat e mëposhtëm duhet të dorëzohen ne momentin e aplikimit në original <u>edhe dy kopje</u></b>		
4.	<b>Kontratë pune ORIGINALE ose Oferte për vend pune</b>	Te nënshkruara nga punëdhënësi dhe punëmarrësi duke u përcaktuar profesioni , <b>Paga bruto, orët e punës/ javë dhe fillimi</b> më i afërt i punësimit të planifikuar.
5.	<b>Njohuri të gjuhës gjermane</b>	<b>Niveli B 2</b> i Kuadrit të Përbashkët Evropian për Referencat e Gjuhëve (KPERGJ).
6.	<b>Leja për ushtrimin e profesionit</b>	Pergjithesisht është një <b>certifikate gjermane</b> për lejen e ushtrimit të profesionit "Infermier"
<b>OSE</b>		
<b>Pjesmarrje në zhvillimin e orëve praktike/teorike për arritjen e njohjes së diplomës tuaj në Gjermani</b>		
<b>Dokumentat e mëposhtëm duhet të paraqiten në original si edhe në <u>dy kopje</u> në momentin e aplikimit</b>		
4.	<b>Kontrata ORIGINALE</b>	për periudhen e praktikës dhe për punësimit e planifikuar pas përfundimit me sukses të praktikës. E nënshkruar nga punëdhënësi dhe punëmarrësi, duke u përcaktuar <b>pagesa mujore bruto, koha javore e punës dhe fillimi</b> i planifikuar i periudhës së praktikës dhe i punësimit.
5.	Vërtetim	i autoriteteve përkatëse gjermane, për orët praktike/ teorike që mungojnë, me qëllim që të arrihet njohja e diplomës në Gjermani.
6.	<b>Njohuri të gjuhës gjermane</b>	<b>Niveli B 1</b> i Kuadrit të Përbashkët Evropian për Referencat e Gjuhëve (KPERGJ).

Dokumenta shtesë, të cilat nuk specifikohen këtu mund të kërkohen më vonë, në çdo rast gjatë aplikimit për vizë ose ne vijim të procesit nga ana e ambasades.

Aplikimi për vizë si ndihmës infermier mund të bëhet vetëm nga shtetas të ballkanit perëndimor.

Pavarësisht nga kohëzgjatja e punësimit në Gjermani, viza ju lëshohet me një kohëzgjatje prej tre deri në gjashtë muaj. Ju lutemi të udhëtoni në kohën e duhur në Gjermani dhe drejtohuni atje te autoritetet përkatëse, të cilat merren me zgjatjen e lejes së qëndrimit dhe që janë autoritetet përkatëse kompetente për të gjitha çështjet tuaja ligjore si të huaj.

### **Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:**

**Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tij.**